

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sarnavap[®]-1000 E

SHTRESË PËR KONTROLLIN E AVUJVE

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sarnavap[®]-1000 E është një shtresë pa mbështetje për kontrollin e avujve me bazë polietileni (PE).

PËRDORIMET

- Shtresa për kontrollin e avujve (vapour control layer, VCL) aplikohet mbi shumicën e nënshtresave të zakonshme. Nënshtresat duhet të jenë të niveluara, të thata dhe të forta për të përballuar qarkullimin e këmbësorëve.
- Nëse nënshtresa është e ashpër (p.sh. beton i papërpunuar), shtroni një shtresë niveluese poshtë Sarnavap[®]-1000 E ose përdorni Sarnavap[®] 3000M, i cili disponon material shkumoz për mbështetje.
- Shtresa për kontrollin e avujve Sarnavap[®]-1000 E përdoret për tarracat e sheshta dhe çatitë me tjegulla.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Vendosje e thjeshtë dhe e shpejtë
- Qëndron elastike në temperatura të ulëta
- Nuk dekompozohet
- Rezistenca konstante ndaj difuzionit të avujve të ujit
- E riciklueshme

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE sipas EN 13984
- Reagimi në zjarr sipas EN 13 501-1
- Sistem i menaxhimit të cilësisë EN ISO 9001/14001

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Fletë polietileni me dendësi të ulët (PE-LD).	
Ambalazhi	Gjatësi ruloni:	25.00 m
	Gjerësi ruloni:	5.00 m
	Peshë ruloni:	24.375 kg
Paraqitja / Ngjyra	Sipërfaqja:	e lëmuar, fletë PE-LD me logon Sarnavap [®] të printuar mbi të.
	Ngjyra:	blu e lehtë
Jetëgjatësia	5 vjet nga data e prodhimit dhe sipas kushteve të përcaktuara të magazinimit, në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar.	
Kushtet e magazinimit	Rulonat duhet të ruhen në temperatura midis +5°C dhe +30°C në pozicion horizontal mbi paletë, të mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor, shiu dhe bora. Mos vendosni paletat e rulonave njëra mbi tjetrën apo materiale të tjera gjatë transportit ose magazinimit.	
Deklarata e produktit	EN 13984	

Defekte të dukshme	Nuk ka	(EN 1850-2)
Gjatësia	25.00 m (± 2 %)	(EN 1848-2)
Gjerësia	5.00 m (± 1 %)	(EN 1848-2)
Trashësia efektive	0.20 mm (± 20 %)	(EN 1849-2)
Drejtvijsia	Kalon	(EN 1848-2)
Masa për njësi sipërfaqeje	195 g/m ² (± 15 %)	(EN 1849-2)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj goditjes	≤ 100 mm	(EN 12691)					
Rezistenca ndaj tërheqjes	<table border="0"> <tr> <td>gjatësore</td> <td>≥ 170 N/50 mm</td> <td rowspan="2">(EN 12311-2)</td> </tr> <tr> <td>tërthore</td> <td>≥ 170 N/50 mm</td> </tr> </table>	gjatësore	≥ 170 N/50 mm	(EN 12311-2)	tërthore	≥ 170 N/50 mm	
gjatësore	≥ 170 N/50 mm	(EN 12311-2)					
tërthore	≥ 170 N/50 mm						
Zgjatimi	<table border="0"> <tr> <td>gjatësor</td> <td>≥ 500 %</td> <td rowspan="2">(EN 12311-2)</td> </tr> <tr> <td>tërthor</td> <td>≥ 500 %</td> </tr> </table>	gjatësor	≥ 500 %	(EN 12311-2)	tërthor	≥ 500 %	
gjatësor	≥ 500 %	(EN 12311-2)					
tërthor	≥ 500 %						
Rezistenca ndaj grisjes	<table border="0"> <tr> <td>gjatësore</td> <td>≥ 120 N</td> <td rowspan="2">(EN 12310-1)</td> </tr> <tr> <td>tërthore</td> <td>≥ 100 N</td> </tr> </table>	gjatësore	≥ 120 N	(EN 12310-1)	tërthore	≥ 100 N	
gjatësore	≥ 120 N	(EN 12310-1)					
tërthore	≥ 100 N						
Reagimi ndaj zjarrit	Kategoria E	(EN ISO 11925-2:2002), (klasifikim sipas EN 13501-1)					
Vjetrimi artificial	Kalon	(EN 1296 / EN 1931)					
Transmetimi i avujve të ujit	≥ 200 m	(EN 1931)					
Papërshkueshmëria e ujit	Kalon	(EN 1928)					

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Produkte shtesë ndihmuese: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sarnavap® Tape F (për izolim hermetik të mbivendosjeve) ▪ Sarnatape® 20 (për izolim hermetik të fundeve, mbi nënshtresa poroze të cilat janë trajtuar më parë me Primer 130) ▪ Primer 130
Kompatibiliteti	Nuk duhet të përdoret për aplikime ku pritet ekspozim i përhershëm ndaj rrezatimit UV.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Temperatura e mjedisit	-20 °C min. / +60 °C max.
Temperatura e nënshtresës	-30 °C min. / +60 °C max.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Nënshtresat duhet të jenë të sheshta, të thata dhe mjaftueshëm të forta për të përballuar qarkullimin e këmbësorëve.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nëse nënshtresat janë të ashpra (p.sh. beton i papërpunuar), instaloni një shtresë niveluese poshtë Sarnavap®-1000 E.

APLIKIMI

1. Çmbështillni Sarnavap®-1000 E mbi nënshtresën strukturore dhe mbaheni përkohësisht në pozicion duke i vënë përsipër ndonjë peshë.
2. Çmbështillni rulinonin e rradhës Sarnavap®-1000 E duke e vendosur në mënyrë të tillë që të sigurohet një mbivendosje minimale prej 80 mm.
3. Palosni fletën e sipërme Sarnavap®-1000 E dhe vendosni Sarnavap® Tape F (shirit bashkimesh) në fletën e poshtme.
4. Hiqni shiritin mbrojtës dhe risillni me kujdes fletën e sipërme Sarnavap®-1000 E në pozicionin e saj duke siguruar se nuk do të krijohen rrudhosje ose palosje.
5. Shtypni fletën e sipërme Sarnavap®-1000 E me rulin që po përdorni për ngjitjen e membranave për të siguruar ndërkapje të mirë mbi shiritin Sarnavap® Tape F. Në nënshtresat metalike mbulimi i fletëve duhet të mbështetet plotësisht në mënyrë që të jetë e mundur të zbatohet presioni i saktë i ngjitjes.
6. Në lidhjet tërthore, ngjitja hermetike arrihet duke prerë skajin e fletës së sipërme në kënd 45°.
7. Për të izoluar Sarnavap®-1000 E në perimetër dhe depërtime, duhet ta ktheni sipër mbi pjesën që del dhe ta izoloni duke e ngjitur mbi nënshtresë me Sarnatape 20. Për izolim hermetik nënshtresat poroze duhet të lyhen me Sarnavap® Primer 130.

Punimet e vendosjes duhet të kryhen vetëm nga aplikuesit e trajnuar nga Sika®.

Aplikimi i disa produkteve ndihmuese, si p.sh shirita dhe prajmer kufizohet në temperaturat mbi +5°C. Ju lutemi lexoni skadat teknike të produkteve përkatëse. Për aplikime në temperatura nën +5°C të temperaturës mjedisit është e detyrueshme të merren masa të posaçme për sigurinë në përputhje me rregulloret kombëtare në fuqi.

Shënim:

Sarnavap®-1000 E nuk është e përshtatshme për hidroizolim të përhershëm. Nuk është krijuar si membranë hidroizolimi tarracash dhe si pasojë nuk mund të zëvendësojë membranën e hidroizolimit.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Sipas udhëzimeve në fuqi të instalimit Sarnavap®-1000 E mund të vendoset me shtrim të lirë mbi sipërfaqe të lëmuar me mbulim minimal midis bashkimeve të fletëve 80 mm dhe izolim të të gjitha mbishtresave me Sarnavap® Tape F (shirit bashkimesh). Në parapetet dhe pjesët që dalin për nga jashtë aplikimi i Sarnavap®-1000 E duhet të bëhet deri në pikën më të lartë të termoizolimit dhe të izolohet tek pjesët që dalin për nga jashtë/ depërtimet me Sarnatape® 20 në mënyrë që të arrihet një izolim hermetik (nënshtresat poroze duhet të trajtohen në fillim me Primer 130). Përpara shtrimit të Sarnavap®-1000 E, duhet bërë kontrolli dhe vlerësimi i nënshtresës. Sarnavap®-1000 E duhet të shtrohet mbi sipërfaqen e nënshtresës që është e lëmuar, e thatë, e pastër dhe mjaft e fortë për të përballuar qarkullimin e këmbësorëve. Nëse sipërfaqja e nënshtresës është e ashpër (p.sh betoni papunuar), vendosni një shtresë nivelimi poshtë Sarnavap®-1000 E ose përdorni Sarnavap® 3000M që disponon shtresë shkumozë në një rëndësi anë. Sarnavap®-1000 E vendoset me shtrim të lirë. Ngaqë

ka peshë të lehtë, duhet të mbulohet (stabilizohet) menjëherë me shtresën vijuese për ndërtimin e tarracës. Nëse Sarnavap®-1000 E vendoset në sipërfaqe vertikale, duhet që skaji i sipërm i saj të mbështetet mekanikisht (ky shënim nuk vlen për pjesët e dala, parapete, etj. të lartësisë së zakonshme). Sipërfaqet e kontaktit të mbivendosjeve duhet të jenë të pastra dhe të thata që të ndërkapen njëra tek tjetra. Duhet të rezervoni 80 mm mbulim midis fletëve të ngjitura. Mbivendosjet duhet të izolojnë hermetikisht me Sarnavap® Tape F.

Praktika e zakonshme e ndërtimit kërkon që shtresa e kontrollit të avujve - barriera e avujve të ujit zgjatet deri tek pika më e lartë e termoizolimit të tarracës dhe të ngjitet në sipërfaqen vertikale të konstruksionit. Shtresa e kontrollit të avujve Sarnavap®-1000 E duhet të ngjitet në mënyrë hermetike me Sarnatape® 20 mbi anën e ngrohtë të konstruksionit vertikal. Nënshtresat poroze duhet të trajtohen në fillim me Primer 130.

KUFIZIME

Përdorimi i shtresës për kontrollin e avujve Sarnavap®-1000 E kufizohet sipas vendndodhjeve gjeografike me temperatura minimale mesatare mujore -50°C. Temperatura e përhershme e ambientit gjatë përdorimit kufizohet në +50°C.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

RREGULLORJA (EC) NO 1907/2006 - REACH

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoqë afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoqë forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sarnavap®-1000 E

Mars 2019, Botimi 01.01

020945051000000008

Sarnavap-1000E-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf